



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 16.09.2019, merr këtë:

VENDIM

për akreditim të grupit të dytë të vëzhguesve të Organizatës Joqeveritare Syri i Vizionit

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, për akreditimin e grupit të dytë të Vëzhguesve të OJQ vendore 'Syri i Vizionit', me shtatëqind e gjashtë (706) vëzhgues, sipas listës së bashkëlidhur këtij vendimi, për vëzhgimin e aktiviteteve zgjedhore për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me 6 tetor 2019.
- II. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftojë OJQ 'Syri i Vizionit', me obligimet e organizatave të akredituara dhe vëzhguesve të tyre që rrjedhin nga neni 4 i Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar ta njoftoj OJQ 'Syri i Vizionit' për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Valdete Daka, Kryetare

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.